



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_949_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1754_01_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **08.03.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.A, nga fshati Gërdovc, Komuna e Besianës, me shifër të konsumatorit **DPR - 90025040** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1754_01_18 i datës 22.01.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 08.03.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimet plotësuese nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2749.28€, të datës 06.10.2016 janë të sakta pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori është regjistruar e tëra në njehsorin elektrik. Në ankesë theksohet po ashtu se njehsori elektrik është dërguar në qendrën e kalibrimit për verifikim dhe se aty është konstatuar se njehsori elektrik benë matje në dy tarifatat edhe përkundër që njëra tarifata ka qene e mbuluar edhe në kohën kur është vendosur njehsori për matje nga ekipet e KEK-ut.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE_V_1754_01_17, në lidhje me shifrën DPR - 90025040 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korrigjimet nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2749.28€, të datës 06.10.2016 janë në përputhshmëri me dispozitat ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin



pretendimet te tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se njehsori elektrik i konsumatorit është pranuar teknikisht nga punëtorët e autorizuar për regjistrim të njehsorit elektrik të KEK-ut me datë 25.10.2001 dhe se nga kjo periudhe konsumatori është faturuar ne një tarife te vetme dhe se ne asnjë rast dhe asnjë procesverbal nuk është identifikuar çfarëdo vërejtje me te cilën do te kërkohej qe te verifikohet njehsori elektrik. Po ashtu sipas nenit 28 paragrafit 2 të rregullës per kushtet e përgjithshme te furnizimit me energji elektrik qartë është e përcaktuar se :” Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e kontrollimit detal te njehsorit elektrik nr. 04422828 ku është theksuar vetëm se në njehsor tabela me të dhëna teknike është e mbuluar me një tiket në tarifën e dytë, dhe se nuk është vërejtur asnjë parregullsi tjetër. Bazuar ne te dhënat e evidentuara dhe per shkak te mos përcaktimit nëse njehsori elektrik benë matjen edhe ne tarifën e dytë Bordi konstaton se koha e kWh të regjistruara ne procesverbal nuk mund te përcaktohet pasi qe njehsori elektrik është pranuar nga ekipet e KEK-ut si teknikisht ne rregull dhe se asnjëherë nuk është tentuar qe te largohet etiketa nga tarifa e dyte me qellim te vërtetimit te shpenzimit te konsumatorit.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në ketë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë për rastet të cilat nuk mund te vërtetohen si dhe per një periudhe te shpenzimit e cila nuk mund te përcaktohet saktë. Andaj edhe është kërkuar të shkarkohet konsumatori nga korrigjimet plotësuese nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2749.28€, të datës 06.10.2016.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.A dhe,
- Arkivit të ZRRE-së